



Ref: 1703/258/BA/AH

BORDI PËR ANKESA, i përbërë nga Avdyl Hyseni, kryetar dhe Dua Dauti-Kadriu e Musa Dragusha, anëtarë, lidhur me ankesën e parashtruar nga IPKO Telecommunications LLC (IPKO), me seli në Prishtinë, me nr të biznesit 70064420, me datën 20.03.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET POSHTE për shqyrtim ankesa e parashtruar nga IPKO Telecommunications LLC (IPKO), me nr të biznesit 70064420 me seli qendrore në lagjen Ulpiana në Prishtinë, për shkak të mungesës së kompetencës lëndore.

A r s y e t i m

I. Prapavija

IPKO Telecommunications LLC (IPKO), me nr të biznesit 70064420 me seli qendrore në lagjen Ulpiana në Prishtinë, me date 23.03.2017, ka parashtruar ankese pran Bordit për Ankesa në Komisionin e Pavarur të Mediave.

II. Kompetenca

Bardi i Ankesave, në Komisionin e Pavarur të Medive, sipas nenit 36 paragrafin 2 të Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, shqyrton ankesat ndaj Vendimeve të Komisionit të Pavarur të Medive.

III. Çështja

Në seancën e shqyrtimit të ankesave, me date 20.03.2017, Bordi hudhi poshtë për shqyrtim Ankesën IPKO Telecommunications LLC (IPKO), me seli ne Prishtinë me nr të biznesit 70064420, pasi që konstatoi se ky organ nuk ka kompetencë lëndore për shqyrtimin e ankesës së paraqitur.

IV. Baza ligjore

Vendimi është marrë konform dispozitave të nenit 36 paragrafin 2 të Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, lidhur me nenin 2 paragrafi 2 i Rregullores BA 2013/01 të Punës së Bordit për Ankesa.

V. Këshilla Juridike


Kundër këtij vendimi mund të iniciohet konflikt administrative me padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë-departamenti për çështje administrative në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Palës dhe
- Arkivit të KPM-së.



Avdyl Hyseni


Kryetar i Bordit për Ankesa